

SOFIA DELIJORGI

**PËRQASJE E TERMINOLOGJISË SË GJUHËSISË NË SHQIPE ME
ATË NË GREQISHTE**

Abstrakt

Në këtë punim jemi marrë me një përqasje të terminologjisë gjuhësore të greqishtes dhe të shqipes, nisur gjithmonë nga renditja e disa termave gjuhësorë që i përkasin fushave të ndryshme gjuhësore: fonetikë – fonologji, morfologji, sintaksë, leksikologji. Duke parë me vëmendje të dyja gjuhët, mund të themi se terminologjia si në shqip ashtu edhe në greqisht është e huazuar nga gjuhët e tjera, edhe pse pjesa më e madhe e termave kanë në përbërje rrënjë të greqishtes, ose të latinishtes si p.sh. *etimologji* / *ετυμολογία*, *polisemi* / *πολυσημία*, *metaforë* / *μεταφορά*. *Morfologji* / *μορφολογία* etj. Nuk mungojnë edhe fjalë të shqipes si *fjalë të parme* apo *të prejardhura*, të cilat zënë një vend më të vogël. Gjithashtu jemi ndalur edhe në një kategori tjetër tek ajo e ndërkombëtarizmave / *διεθνισμοί*. Në këtë punim kemi paraqitur pikërisht disa veçori të terminologjisë gjuhësore.

Sipas Agron Duros, E. Vysteri, me veprën e tij “Internationale Sprachnormung in der Technik” (1931), është themeluesi i teorisë së terminologjisë. Vysteri e përcaktoi terminologjinë si shkencë, e ngriti terminologjinë nga një fushë e praktikës terminologjike, e kufizuar në mbledhjen, në regjistrimin e termave dhe në hartimin e fjalorëve terminologjikë, në shkencën mbi termat dhe konceptet me teorinë e përgjithshme të veçantë të saj, të bazuar mbi parime dhe metoda shkencore¹. Në vazhdim studimet u thelluan më tej nga studiues të tjerë të ndikuar prej tij. Ata u përqendruan kryesisht në një varg dukurish gjuhësore, vështuar nga pikëpamja specifike e terminologjisë, si polisemia, homonimia, sinonimia e pseudosinonimia, si dhe tek tiparet e termave, si njëkuptimësia e saktësia, tek asnjënjësia konotative që lidhet me shkarkimin e termave nga ngjyresat emocionale e të figurshme².

Leksiku terminologjik përbën një nënsistem brenda sistemit leksikor të gjuhës standarde shqipe dhe lidhet me të me fjalë të shumta si nga pikënisja e formës, ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes.

¹ A. Duro, *Terminologji, gjuhësi kompjuterike*, Studime gjuhësore, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2012, f. 23.

² Shih më gjërë po aty, f. 24.

Kriteri bazë i identifikimit të termit është aftësia e tij vetëmotivuese jashtë kontekstit, pra motivimi i tij i drejtpërdrejtë me konceptin që shpreh. Termat kuptimi i së cilëve zbulohet jashtë kontekstit, quhen terma të mirëfilltë ose të pastër. Termat e gramatikës si p.sh.: *përemër, emërzim, shquarsi, theks, togfjalësh, i nyjshëm, i panyjshëm, trajtëformim, fjalëformim, fjali, folje, ndajfolje, përcaktor, kundrinor, thirror, ndajshim* etj. janë terma të mirëfilltë. Leksiku terminologjik i gjuhësisë përbëhet kryesisht nga terma të mirëfilltë³.

Por kur i njëjti term shfaqet dhe emërton koncepte të ndryshme atëherë duhet saktësuar e duhet të parë fusha e përdorimit që shërben si kontekst i jashtëm i termit, pra në varësi gjithmonë të kontekstit në të cilën përdoret vetë termi. P.sh., njësia *gjymtyrë* ose njësia *pikë*, identifikohen si terma në fusha të ndryshme si në matematikë, fjala *pikë*, në mjekësi, fjala *gjymtyrë* dhe njëherazi edhe në gjuhësi, por jashtë këtyre fushave e humbasin këtë vlerë dhe i takojnë leksikut të përgjithshëm.

Për të parë qartë larminë terminologjike gjuhësore dhe për të krahasuar këto terma në të dyja gjuhët po bëjmë një renditje të këtyre njësive sipas fushave përkatëse gjuhësore, si në fushën e fonetikë-fonologjisë, morfologjisë, leksikologjisë dhe sintaksës.

Fonetikë⁴

drejtshqiptimi(ortoepia)
ligjërimi
tinguj
nyjëtim
linrare
jo lineare
intonacioni
aspekt nyjëtimor
aspekt akustik
aspekti funksional
fonologjik
intensiteti i tingullit
theksi
laringu
tejzat e zërit
mbiglotës
fonemat
variantet (alofonemat)

Φωνητική

ορθοέπεια, ορθοφωνία
λόγος
φθόγγοι
άρθρωση
γραμματική
μη γραμμική
επιτονισμός
αρθρωτική
ακουστική
λειτουργική
φωνολογικό
η ένταση του φθόγγου
τόνος
λάρυγγας
φωνητικές χορδές
επιγλωττίδα
φωνήματα
αλλόφωνα

³ F. Çitaku, *Konceptet themelore të terminologjisë*, Filologji, Universiteti i Prishtinës, Prishtina 2010, f. 77.

⁴ A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.

Përqasje e terminologjisë së gjuhësisë në shqipe me atë në greqishtë

<i>të zhurmëta(sonante)</i>	<i>ηχηρά</i>
<i>të përparme</i>	<i>πρόσθια</i>
<i>qendrore</i>	<i>κεντρικά</i>
<i>të prapme</i>	<i>οπίσθια</i>
<i>sinkopa</i>	<i>συγκοπή</i>
<i>afereza</i>	<i>αφαίρεση</i>
<i>apokopa</i>	<i>αποκοπή</i>
<i>elizioni</i>	<i>έκθλιψη</i>
<i>qiellzorizimi</i>	<i>ουρανικοποίηση</i>
<i>metateza</i>	<i>μετάθεση</i>
<i>sinalefa</i>	<i>συναλοιφή</i>
<i>sinereza</i>	<i>συναίρεση</i>

Nga sa përmendëm më sipër në përqasjen e termave të fushës së fonetikë-fonologjisë dallohet qartë se shumë prej tyre janë me burim nga greqishtja dhe i janë përshtatur sistemit fonetik të shqipes: *metateza*, *afereza*, *apokopa* etj. Gjithashtu ka edhe terma që i përkasin shqipes si: *të përparme*, *qendrore*, *të prapme*, por në këtë kategori mund të ndeshim krahas termit të shqipes edhe atë të huazuar me një përdorim të dyfishtë si: *të zhurmëta (sonante)*, *variantet (alofonemat)*, *drejtshqiptimi (ortoepia)*. Gjuha greke përta i përket terminologjisë së fushës së fonetikës, por edhe fushave të tjera gjuhësore dallohet për karakterin e saj konservator. Nuk lejon huazimin e termave nga gjuhë të tjera perëndimore veç atyre me etimologji (burim) nga greqishtja.

Morfologji:

Morfemë
emër
folje
përemër
mbiemër
numëror
ndajfol
parafjalë
lidhëza
pasthirma
paskajore
pjesore
augment
lakim

Μορφολογία⁵

μόρφημα
ουσιαστικό
ρήμα
αντωνυμίες
επίθετα
αριθμητικά
επιρρήματα
προθέσεις
σύνδεσμοι
επιφωνήματα
απαρέμφατο
μετοχή
αύξηση
κλίση

⁵ M. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική Γραμματική*, Οργανισμός εκδόσεων διδακτικών βιβλίων, Αθήνα.

<i>rasat</i>	<i>πτώσεις</i>
<i>gjinia</i>	<i>το γένος</i>
<i>gjinia mashkullore</i>	<i>αρσενικό γένος</i>
<i>gjinia femërore</i>	<i>θηλυκό γένος</i>
<i>gjinia asnjane</i>	<i>ουδέτερο γένος</i>
<i>zgjedhim</i>	<i>συζυγία</i>
<i>kohët</i>	<i>χρόνοι</i>
<i>vetat</i>	<i>πρόσωπα</i>
<i>diatezat</i>	<i>διάθεση</i>

Duke parë me vëmendje terminologjinë që i përket fushës së morfologjisë vëmë re se shumë prej fjalëve janë shqipe, por edhe të huazuara dhe kalke nga gjuhët e tjera. Kalke: *përemër* (αντωνυμίες), *parafjalë* (προθέσεις), *pasthirrmat* (επιφωνήματα). Të huazuara: *morfologji*, *diatezë*, *augment*, *morfemë*, fjalë të shqipes: *paskajore*, *emër*, *folje* etj.

Leksikologji:⁶

Leksiku
semasiologji/ semantikë
fusha leksikore
frazologji
homonimi (homonimet)
sinonimi (sinonimet)
antonimi (antonimet)
polisemi
metonimi
hiponimi
metaforë
etimologji
konversion
të parme
të prejardhura
kompozitë
kalket
huazimet
neologjizmat
terminologji

Λεξικολογία:⁷

λεξιλόγιο
σημασιολογία
λεξικολογικά παιδία
φρασεολογία
ομωνυμία (ομώνυμα)
συνωνυμία (συνώνυμα)
αντωνυμία (αντώνυμα)
πολυσημία
μετωνυμία
υπωνυμία
μεταφορά
ετυμολογία
μετάπλαση
απλές λέξεις
παράγωγες λέξεις
σύνθετο
μεταφραστικά δάνεια/έκτυπα
δάνεια
νεολογισμοί
ορολογία

Duke qenë se edhe vetë leksikologjia është relativisht më e re si shkencë, mund të themi se terminologjia si në shqip ashtu edhe në greqisht është e

⁶ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe, botimet Toena, Tiranë, 2006.*

⁷ Ξυδόπουλος, *Λεξικολογία, εισαγωγή στην ανάλυση της λέξης και του λεξικού*, Πατακίς 2008.

Përqaasje e terminologjisë së gjuhësisë në shqipe me atë në greqishte

huazuar nga gjuhët e tjera, edhe pse pjesa më e madhe e termave kanë në përbërje rrënjë të greqishtes, *etimologji* / *ετυμολογία*, *polisemi* / *πολυσημία*, *metaforë* / *μεταφορά*. Nuk mungojnë edhe fjalë të shqipes si *fjalë të parme* apo *të prejardhura*, të cilat zënë një vend më të vogël.

Sintaksë:

Fjali

Kryefjalë

Kallëzues

Përcaktor

Rrethanor

Kundrinor i drejtë

Kundrinor i zhdrejtë

Ndajshim

Përcaktor kallëzuesor

Συντακτικό

Πρόταση

Υποκείμενο

Κατηγορία

Προσδιορισμός

Επιρρηματικός προσδιορισμός

Άμεσο αντικείμενο

Έμμεσο αντικείμενο

Παράθεση, Επεξήγηση

Κατηγορούμενο

Edhe në fushën e sintaksës gjuha shqipe dhe gjuha greke kanë veçoritë dhe ngjashmëritë e tyre. Vetë termi *συντακτικό* / *σύνταξη* - sintaksë është i huazuar nga greqishtja dhe e ka prejardhjen nga folja *συντάσσω* që ka kuptimin e rreshtoj, bashkërendis. Terminologjia është e larmishme. Siç do të vëmë re në tabelën e mëposhtme terma si *fjali*, *kryefjalë*, *kallëzues*, *përcaktor*, *kundrinor* kanë gjegjëset e tyre në greqishte. Termit *ndajshim* i korrespondojnë dy terma në greqishte *παράθεση* dhe *επεξήγηση*, ku secili ka specifikat e veta. Ndërsa *rrethanori* i shqipes në greqishte jepet me termin *επιρρηματικός προσδιορισμός* që do të thotë përcaktor ndajfoljor. Pra *rrethanori* në greqishte është pjesë e përcaktorëve. Ka edhe terma që ekzistojnë në shqipe dhe nuk ekzistojnë në greqishte. Të tilla janë: *gjymtyrë homogjene*, *përcaktor me bashkim*, *përcaktor me përshtatje*, *përcaktor me drejtim*. Këta terma dygjymtyrësh në greqishte kanë barasvlerës një emër + një emër në gjinore dhe shprehin pronësi, cilësi, qëllim, veprues (kryefjalë), objekt të rënies së veprimit (kundrinë) etj.

Pra disa prej termave gjuhësore që përmendëm gjatë punimit kanë përdorim të dyfishtë, koncepti i fjalës i shprehur nga termi dhe koncepti i shprehur nga fjala, p.sh. *prejardhja* e dikujt, *prejardhja* (term gjuhësor), *emri* i një personi, *emri* (term gjuhësor) etj.

Disa fjalë identifikohen si terma vetëm kur shërbejnë për formimin e disa togfjalëshave që sipas përdorimit mund të jenë terma ose jo, p.sh. *mënyrë jetesë*, *mënyrë lidhore* (term), *gjymtyrë e trupit*, *por themi edhe gjymtyrë e fjalisë* (term), *shkalla e shtëpisë*, *shkalla e mbiemrit* (term), *shenjë*, *shenjë pikësimi* (term). Pra këto fjalë transformohen në terma kur formojnë togfjalësha terminologjike të qëndrueshëm.

Një kategori tjetër në terminologjinë e shqipes janë edhe huazimet leksikore në shqipe nga gjuhë të tjera mund t'i shohim edhe sipas vlerës së përgjithshme, duke i grupuar në fjalë të huaja dhe në fjalë ndërkombëtare⁸. Fjalët ndërkombëtare, që i takojnë më shumë terminologjisë, janë përvetësuar më lehtë, kanë zënë vend më shpejt në gjuhë, janë më të qëndrueshme.

Prof. Sh. Demiraj pohon për këtë se “në gjuhën shqipe, sidomos në shekullin tonë (është fjala për shekullin XX, shënimi ynë – SD), kanë hyrë edhe një numër i konsiderueshëm fjalësh që kanë një përdorim të gjerë edhe në gjuhët e tjera. Këto janë kryesisht fjalë terma, që njihen me emrin ndërkombëtarizma. Këto huazime, pavarësisht nga burimi i tyre, kanë depërtuar në shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhëve romane (sidomos nga italishtja) dhe gjermanike (sidomos nga anglishtja). Ato u përkasin sferave të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, arteve, sporteve etj.”⁹

Fjalët e huaja, duke hyrë në gjuhën tonë, mund të kenë pësuar edhe ndryshime në formë e në përmbajtje. Pra, gjuha jonë i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar këto fjalë sidomos në rrafshin fonetik dhe në atë morfologjik (eptimor, si lakim dhe si zgjedhim) ashtu si fjalët e veta.

Kurse fjalët ndërkombëtare kanë karakter më ruajtës, më të qëndrueshëm. Ato zakonisht janë terma emra dhe u përkasin fushave të ndryshme të dijes, të shkencës, të teknikës dhe të artit.

Po japim një pasqyrë të përmbledhur të termave gjuhësore ndërkombëtare me origjinë greke¹⁰ që janë bërë pjesë e pandashme e leksikut terminologjik të shqipes, ashtu si edhe i gjuhëve të tjera me shkallë të ndryshme përpunimi a rëndësie komunikimi: *epentetik, etimolog etimologji, faring, laringal, fonetikë, fonologji, glosemë, glosografi, glotë, glotogoni, grafemë, grafologji, gramatikë, gramatologji, hieroglif, hiperdialekt, homonimi, ideofon, idioglosë, idiolekt, idiomë, izomorf, izomorfemë, ksilografi, metonimi, metonomazi, morfofonemë, morfosintaksë, morfonologjik, neologjizëm, onomasiologji, onomastikë, onomatologji, onomatope, ortofoni, ortoepi, ortogram, semiologji, semantikë, semasiologji, sinharmoni, sinonim sinonimi, stenografi, zeugmë, gnoseologji (filoz.).*

Por termat me burim grek nuk i përkasin vetëm fushës së gjuhësisë, por edhe fushave të tjera shkencore. Një pjesë e këtyre termave (që u përkasin

⁸ Në vazhdim jemi marrë dhe me greqizmat në shqipe, si **huazime gjuhësore** dhe **jo si huazime historiko-kulturore**. Këto ndeshen shpesh në ligjërimin e folur, dhe sidomos në të folmet dialektore të jugut, mbartësit e të cilave janë në kontakte të drejtpërdrejta popullsinë e Greqisë Veriore, por edhe me mediet greke, sidomos me ato televizive. Gjithashtu, këtu kanë ndikuar lëvizjet e lira të popullsisë në këto treva, përkëtej e përtej kufirit shtetëror.

⁹ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 129.

¹⁰ Gjatë trajtimit të huazimeve greke në shqipe (pavarësisht nga rruga e hyrjes) ne nuk jemi ndalur tek huazimet që janë terma të përbërë nga një element latin dhe një element grek ose anasjelltas: si *radioskopi, planimetri* etj. ose *hidrocentral, monovalent* etj.

fushave të ndryshme) kanë përdorim shumë të gjerë në komunikimin e përditshëm dhe janë bërë pjesë e leksikut të përgjithshëm; ata i gjejmë edhe në fjalorët filologjikë ose shpjegues të shqipes (*kimi, fizikë, gramatikë, fonetikë, semantikë, leksikologji, leksikografi, gjeografi, gjeodezi, gjeometri* etj.).¹¹ Kurse termat e tjerë i gjejmë nëpër fjalorët terminologjikë, sepse u përkasin fushave të ngushta të përdorimit.

Një problem interesant është se terminologjia me burim nga greqishtja *nuk është huazuar nga greqishtja drejtpërdrejt, por tërthorazi*. Shkencat shqiptare përgjithësisht janë shkenca të reja dhe terminologjinë shkencore e kanë marrë nga shkencat e vendeve perëndimore. Këto në vetvete i kanë ndërtuar termat mbi bazën e greqishtes së vjetër dhe të latinishtes, një proces që vazhdon sot e kësaj dite. Kështu pjesa dërmuese a termave kanë hyrë në shekullin XX në shqipe nga italishtja, anglishtja, frëngjishtja, rusishtja dhe nga gjermanishtja.

Gjuha shqipe shumicën e këtyre termave në përdorim e ka kodifikuar, e ka standardizuar dhe e ka pasqyruar në fjalorë terminologjikë (madje edhe në fjalorë filologjikë). Është për t'u habitur që në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që ka qenë në vartësi të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, asnjë fjalor terminologjik (kur janë hartuar rreth 60 të tillë), nuk e ka fjalësin në greqisht ose nuk mbështetet në terminologjinë e përpunuar nga shkenca gjuhësore greke.

BIBLIOGRAFI

- A. Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.
- A. Duro, *Studime gjuhësore, Terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografi*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2012.
- F. Çitaku, *Konceptet themelore për terminologjinë*, Filologji, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2010.
- J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, botimet Toena, Tiranë, 2006.
- Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
- Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik, në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980), SF, 1986/2.
- Γ. Ξυδόπουλος, *Λεξικολογία, εισαγωγή στην ανάλυση της λέξης και του λεξικού*, Πατακίς 2008.
- M. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική*, Οργανισμός εκδόσεων διδακτικών βιβλίων, Αθήνα.

¹¹ Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik, në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980), SF, 1986/2.

